

TLAS



SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 3 / 2011

**Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS
Organizon Takimin e Tretë Rajonal**

ZHVILLIMI I INISIATIVES SE OHRIT PER FUNKSIONIMIN E NDIHMES JURIDIKE FALAS NE RAJON

Durrës: 11, 12 Tetor 2011

**Botimi i këtij materiali është mbështetur
financiarisht nga CIVIL RIGHTS DEFENDERS**



MISIONI I TLAS

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) është regjistruar si organizatë jo fitimprurëse, e pavarur, me Vendimin Gjykatë Nr. 346, datë 18/12/2006, themeluar nga CAFOD UK.

TLAS ka filluar aktivitetin si program i Cafod Albania, që në vitin 1999 dhe vazhdon të ofrojë shërbim ligjor falas për kategoritë në nevojë për çështje civile.

Plotësimi i nevojave ligjore të njerëzve në nevojë, sensibilizimi i tyre mbi të drejtat themelore të njeriut, nxitja e ndryshimeve të sistemit ligjor, në funksion të përmirësimit të kushteve ekonomiko-sociale të individëve dhe grupeve vulnerabël.

OBJEKTIVAT E TLAS

- Të ofrojë shërbime të plota ligjore për shtresat në nevojë të shoqërisë;
- Të sigurojë që njerëzit në nevojë të kenë më shumë akses në sistemin ligjor;
- Të ndërmarrë inisiativa për përmirësime në legjislacion, advokim dhe lobbying për realizimin e tyre;
- Të ndikojë në përmirësimin e qeverisjes, përmes përfshirjes së grupeve vulnerabël;
- Të botojë të dhëna mbi probleme të rëndësishme ligjore dhe të të drejtave të njeriut, që janë ndeshur gjatë trajtimit të rasteve të klientëve të TLAS.

BORDI DREJTUES

Av. Dashamir Kore
Av. Maksim Haxhia
Suzana Sakiqi
Shkëlqim Bozgo
Viktor Gumi

GRUPI KËSHILLIMOR

Av. Ardjana Fullani
Dr. Tefta Zaka
Av. Dashamir Kore
Av. Natasha Sheshi
Av. Perikli Zaharia

STAFI I TLAS

Dr. Rajmonda Bozo
Av. Vangjel Kosta
Av. Elton Lula
Dr. Elvira Dervishi
Av. Naureda Llagami
Migen Elmazaj
Av. Anisa Haxhijaj
Av. Adrian Shega

FORUMI PËR NDIHMË LIGJORE NË BALLKAN

Çfarë është Forumi për Ndi- hmë Ligjore në Ballkan?

Forumit për ndihmë ligjore në Ballkan u krijua në muajin Tetor të vitit 2009 me iniciativën e 7 organizatave të ballkanit që ofrojnë ndihmë ligjore falas. Pjesë e këtij forumi janë:

1. Macedonian Young Lawyers Association (MYLA), organizatë që ushtron aktivitetin në Maqedoni.
2. Civil Rights Program in Kosovo (CRPK), organizatë që ushtron aktivitetin e saj në Kosovë.
3. Tirana Legal Aid Society (TLAS), organizatë që ushtron aktivitetin në Shqipëri.
4. The Young Lawyers of Serbia (YLS), organizatë që ushtron aktivitetin në Serbi.

5. Legalis, organizatë që ushtron aktivitetin në Kroaci.

6. Association Vasa Prava BiH, organizatë që ushtron aktivitetin e saj në Bosnjë Hercegovinë.

7. Youth Initiative for Human Rights, organizatë që ushtron aktivitetin në Malin e Zi.

Qëllimi i krijimit të forumit është përballja me sfidat që shqetësojnë vendet e Ballkanit në dhënien e ndihmës ligjore falas si dhe lobimi në çështjet e legjis-





lacionit që prek dhënien e ndihmës juridike.

Aktualisht forumi ka realizuar 3 takime rajonale, takimi i parë u zhvillua në shtetin e Maqedonisë në qytetin e Ohrit në vitin 2009 ku u firmos edhe memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave për krijimin e Forumit për Ndihmë Ligjore në Ballkan. Takimi i dytë u zhvillua në vitin 2010 në Podgoricë të Malit të Zi dhe takimi i tretë u zhvillua në Shqipëri në qytetin e Durrësit.

Në takimin e tretë i cili u zhvillua me iniciativën e Shërbimit Ligjor Falas në qytetin e Durrësit morën pjesë 4 organizata të fo-

rumit ndërsa 3 organizata munguan për arsye fondesh dhe nuk mund të ishin të pranishme në këtë takim pavarësisht se shprehën mbështetjen e tyre për ecurinë e forumit.

Risia e takimit rajonal të zhvilluar në qytetin e Durrësit ishte pjesëmarrja në këtë takim të dy nga ekspertëve më të mirë në fushën e ndihmës juridike në Shtetet e Bashkuara dhe në Europë. Nga shtetet e Bashkuara ishte i pranishëm Z. Daniel Manning dhe nga Rusia ishte i pranishëm Z. Dmitry Shabelnikov. Të dy ekspertët ishin mjaft të interesuar për të ndjekur mënyrën e punës së forumit dhe për të dhënë eksperiencën e tyre nëse do ishte e nevojshme.

Në këtë takim u diskutuan disa çështje kryesore . Në ditën e parë u diskutua mbi zhvillimet më të fundit në shtetet përkatëse të situatës së ndihmës ligjore.

Në fjalën e tij përfaqësuesi i Bosnje Hercegovinës vuri theksin në çështjet kryesore që shqetësojnë këtë vend përsa i përket fushës së ndihmës ligjore dhe

theksoi se: Aktualisht përsa i përket situatës ligjore në Bosnje nuk ka progres përsa i përket ligjit të ndihmës juridike dhe situatës ligjore në përgjithësi. Aktualisht nuk ka një ligj për ndihmën juridike, por është ngritur një grup pune nga Ministria e Drejtësisë që po punon me një draft për ligjin për ndihmën juridike. Mungesa e gjatë e ligjit për ndihmën juridike ka bërë që disa organizata që ofronin ndihmë ligjore të shkojnë drejt mbylljes për shkak të problemeve financiare. Aktualisht Vasa Prava është e vetmja organizatë që po i reziston situatës të vështirë dhe boshllëkut ligjor që është krijuar.

Për draftin për ligjin për ndihmën juridike po punohet aktualisht por Vasa Prava i ka bojkotuar mbledhjet për shkak se kërkesat e tyre nuk merren parasysh nga grupi i punës i ngritur nga Ministria e Drejtësisë. Kërkesat e tyre janë që organizatat jo fitimprurëse të merren seriozisht nga ligji për ndihmën juridike dhe të jenë pjesë e tij.

Sistemi është i fragmentuar dhe ka shumë probleme. Të gjitha kantonet dhe Republika Serbe

kanë një ligj për ndihmën juridike ndërsa BH nuk ka. Në Republikën Serbe ligji për ndihmën juridike përjashton dhënien e ndihmës për çështjet administrative.

Edhe në BH draft ligji për ndihmën juridike kërkon të bëjë të njëjtën gjë si në Republikën Serbe dhe shteti nuk po punon për të rregulluar këto probleme.

Në Republikën Serbe dhe në 4 kantonet e tjera që kanë një ligj mënyra e veprimtarisë varet gjithmonë nga buxhetet. Pasi jepet ndihmë juridike për një periudhë 3 muajore e më pas deri në fund të vitit nuk jepet me





ndihmë juridike për shkak se nuk ka më buxhet për të mbuluar çështjet.

Implementimi i sistemit të ndihmës juridike është shumë i vështirë për shkak të sistemit federal pasi një pjesë ka ligj të adoptuar dhe një pjesë nuk ka duke krijuar kështu vështirësi të mëdha.

Shumica e zyrave të ndihmës ligjore japin ndihmë vetëm për çështje penale, shumë pak në çështje civile dhe çështje administrative.

Shumica e zyrave ofrojnë ndihmë juridike vetëm për çështje të fushës penale.

Qeveria përcakton drejtorin e Komisionit të Ndihmës Juridike duke përcaktuar në këto poste funksionarë politikë të saj.

Sistemi funksionon duke dhënë ndihmë juridike avokatët privat dhe organizatat jo fitimprurëse, dhe pothuajse gati të gjithë fondet shkojnë për çështje penale duke injoruar të gjitha çështjet civile dhe administrative.

Aktualisht Vasa Prava po lobon që ligji që do të miratohet të bëjë të mundur një mbulim sa më të mirë të të gjitha çështjeve dhe të bëjë të mundur aksesin në drejtësi për të gjithë qytetaret që kërkojnë ndihmë juridike.

Shumica e drejtuesve të komisioneve të ndihmës juridike në kantone janë ish-punonjës të qeverisë dhe kanë pasur poste politike.

Pra si përfundim situata e ndihmës ligjore në BH është shumë e vështirë dhe për momentin çdo gjë është bllokuar duke krijuar një boshllëk të madh në sistem.

I dyti e mori fjalën përfaqësuesi i shtetit të Kosovës i cili në fjalën e tij theksoi: Nga viti 2004 organiza-

ta “Programi për të drejtat civile Kosovë” është organizata më e madhe në Kosovë që ofron ndihmë juridike duke numëruar aktualisht 50 persona të punësuar duke u marrë me çështjet që shqetësojnë më shumë situatën si azilkërkuesit, të papunët dhe familjet e varfëra.

Kosova kishte një ligj për ndihmën juridike, ligj i cili krijonte shumë hapsira në dhënien e ndihmës juridike. Aktualisht po punohet me një draft ligj të ri dhe programi për të drejtat civile Kosovë ka krijuar një grup ekspertësh të cilët po llobojnë në Ministrinë e Drejtësisë për të pasur një ligj sa më të mirë i cili të plotësojë sa më shumë nevojat e qytetarëve dhe tu krijojë atyre lehtësi duke pasur një akses sa më të mirë në drejtësi.

Aktualisht situata në Kosovë nuk është shumë e mirë përse i përket ekzekutimit të vendimeve pasi administrata nuk pranon të ekzekutojë vendimet e gjykatave, Kjo kryesisht sepse juristët që janë pjesë e administratës janë shumë të rinj dhe nuk kanë kualifikimin e duhur profesional.



Aktualisht është krijuar një boshllëk ligjor dhe qeveria po mundohet që me ligjin e ri të mbulojë të gjitha problemet ekzistuese dhe të sjellë një ndryshim të situatës. Ndoshta ligji i ri për ndihmën juridike që do të miratohet mund ti mbulojë të gjitha problemet që janë krijuar deri tani.

Aktualisht me ligjin e ri mendohet që prioritet të kenë minoriteti rom dhe çështjet që kanë të bëjnë me të miturit.

Ligji aktualisht siguron dhënien e ndihmës ligjore për çështje administrative, civile dhe penale. Kosova aktualisht ka një situatë

të vështirë përsa i përket dërgimit të çështjeve në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut është pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe aplikohet në dhënien e drejtësisë dhe standartet e saj respektohen por qytetarët e shtetit të Kosovës nuk mund ti drejtohen gjykatës së Strasburgut si shtet i veçantë.

Përfundimisht në Kosovë ka mjaft probleme por shpresojmë që situata me miratimin e ligjit të ri për ndihmë juridike të përmirësohet.

I treti e mori fjalën përfaqësuesi i Shërbimit Ligjor Falas për Shqipërinë i cili theksoi:

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë është organizata më e madhe në Shqipëri që ofron ndihmë juridike falas që prej vitit 1999. Përsa i përket situatës në lidhje me ligjin për ndihmën juridike aktualisht në Shqipëri ka një situatë ligjore dhe një situatë faktike.

Situata ligjore është e tillë që egziston një ligj për ndihmën juridike i cili është miratuar me lobimin e fuqishëm të “Shërbimit Ligjor Falas Tiranë” në vitin 2008 dhe gjithashtu është krijuar Komisioni i Ndihmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë ku “Shërbimit Ligjor Falas Tiranë” ka një anëtar të vetin. Gjithashtu po bëhet një periudhe rreth 5 mujore që kjo zyre ka hartuar aktet nënligjore të nevojshëm për funksionimin e Komisionit të Ndihmës Juridike dhe ligjit në përgjithësi. Këto akte nënligjore i kanë kaluar të gjithë fazën e diskutimit me aktorët dhe organizatat e tjera që ushtrojnë aktivitet në këtë fushë dhe aktualisht aktet nënligjore ndodhen në Komisionin e Ndi-



mës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë por deri në momentin që flasim nuk është bërë asnjë hap për miratimin e këtyre akteve nënligjore.

Përsa i përket situatës faktike mund të themi se sistemi ka ngecur në një ngërç të madh pasi pavarësisht se kemi një ligj për ndihmën juridike dhe pavarësisht se kemi një Komision të Ndihmës Juridike nuk ka filluar akoma dhënia e ndihmës juridike nga shteti për shtresat në nevojë të popullsisë. Aktualisht Komisioni i Ndihmës Juridike ka një fond të limituar por që nuk po e përdor për ofrimin e ndihmës juridike por po e mban të bllokuar duke mos kryer asnjë veprim, madje vlen të theksohet fakti se komisioni gjithashtu nuk ka kryer hapa parpara përsa i përket krijimit të zyrave vendore nëpër rrethe të tjera si dhe përsa i përket marrëveshjeve që do të nënshkruajë me organizatat që do të ofrojnë këtë shërbim dhe avokatët privat që gjithashtu do të përfshihen në këtë skemë të dhënies së ndihmës juridike. Pra situatë nuk paraqitet e mire,



vetëm duke shpresuar se nga Janari i vitit 2012 komisioni të fillojë realisht nga puna me fondet që i janë vënë në dispozicion nga shteti.

I katërti e mori fjalën përfaqësuesi i shtetit Maqedonas i cili në fjalën e tij theksoi:

Në vitin 2007 filloi puna për hartimin e një ligji për Ndihmën Juridike me iniciativën e vetme të qeverisë duke lënë jashtë të gjitha organizatat që ofronin ndihmë juridike në Maqedoni. Me një lobim të fortë dhe sidomos me mbështetjen e OSBE qeveria e Maqedonisë pra-



noi që organizatat të bëheshin pjesë e hartuesve të ligjit dhe të jepnin ndihmesën e tyre për të pasur një ligj që të mbronte sa më mirë shtresat e varfëra. Janë krijuar disa draft ligje të cilat janë kthyer disa herë për shkak të problemeve që kanë dalë gjatë diskutimeve vetëm në vitin 2010 Maqedonia ka një ligj për ndihmën juridike.

Ligji vazhdon akoma të ketë mjaft probleme pasi nuk i përshtatet nevojave të qytetarit. Kriteri i aplikimit është problemi më i madh i ligjit pasi ka vendosur kriterë shumë strikte duke

vendosur një klauzolë që personat që kanë pasuri më shumë se 2700 Euro duke përfshirë edhe pasurinë e paluajtshme nuk mund të përfitojnë nga ligji për ndihmën juridike. Në këto kushte ka më shumë aplikime të refuzuara se sa të pranuar për shkak të pasurive që posedojnë aplikuesit në rastin konkret banesat ku ata jetojnë. Vetëm në vitin e parë të funksionimit të ligjit ka pasur 172 aplikime nga të cilat 55 janë pranuar dhe 63 janë refuzuar.

Si përfundim ligji për ndihmën juridike është i kufizuar dhe nuk përfshin në skemën e tij të gjithë qytetarët që nuk mund të përballojnë me të ardhurat e tyre pagesën e një avokati. Ligji kur u krijua nuk u adoptua me ligjin e taksave në Maqedoni dhe ligjin e Proçedurës Civile.

Nenet që rregullojnë dhënien e ndihmës juridike janë të pa aplikueshme dhe ngatërrohen me njëri tjetrin.

Proçedura e parashikuar me ligj është e paefektshme pasi vënon aksesin në drejtësi për shtresat e varfëra të popullsisë.

Më e rëndësishmja është urgjentisht i nevojshëm miratimi i amendamenteve në ligjin për ndihmën juridike me qëllim që ligji të jetë gjithëpërfshirës.

Në ditën e dytë të takimit u diskutua në lidhje me funksionimin e forumit duke krijuar hapa konkrete.

Fillimisht u diskutua mundësia e hapjes së një faqe interneti për të paraqitur iniciativën e forumit dhe problemet që hasen në çdo shtet në dhënien e ndihmës juridike. Nga anëtarët e tjerë u mendua që kjo pikë të kalohej dhe të diskutohej me pikën tjetër e cila ishte më parësore përse i përket funksionimit të forumit.

U diskutua në lidhje me krijimin e organeve drejtuese të forumit duke propozuar krijimin e një Bordi Menaxherësh dhe një sekretariati.

Bordi do të përbëhet nga një përfaqësues i çdo shteti dhe do të ketë një kryetar i cili do të zgjidhet nga anëtarët e tij.

Përse i përket sekretariatit do të përbëhet nga një person i cili do

të caktohet nga organizatat e forumit dhe do të shërbejë për të ndihmuar bordin në punën e tij. Gjithashtu u diskutua që të përcaktohen saktësisht se cilat do të jenë kompetencat e Bordit dhe sekretariatit dhe si do të sigurohen fondet për personat që do të punësohen pranë këtyre organeve.

Nga pjesmarrësit u propozua se forumi ka si problem parësor të tijin përcaktimin e qëllimit dhe misionit të forumit. Gjithashtu anëtarësimi në forum të bëhet me pagesë dhe anëtarët e tjerë që do të dëshirojnë të jenë pjesë e forumit të kenë si aktiv-



itet të tyre dhënie e ndihmës juridike.

Gjithashtu nga ekspertët e huaj u vu theksi në përcaktimin e qëllimit dhe misionit të forumit të cilët do të shërbenin si fillimi i funksionimit të forumit dhe më pas të krijohej një strukturë organizative e forumit.

Gjithashtu u propozua nga ekspertët e huaj mundësia e krijimit të një Bordi Këshillues me anëtarë të ndryshëm nga vënde të ndryshme të cilët mund të këshillojnë forumin në

rastet të veçanta për problemet që mund të dalin gjatë funksionimit të tij.

Në përfundim të ditës së dytë të takimit u vendos që të realizoheshin këto hapa:

1. Dy nga organizatat MYLA dhe Vasa Prava do të përcaktojnë qëllimin dhe misionin e forumit si dhe strategjinë e tij. Këto materiale brenda 2 muajsh do të shpërndahen tek anëtarët e tjerë me qëllim që të merren sugjerime nga të gjithë anëtarët.

2. Çdo anëtar i forumit duhet të përgatisë një raport progresiv për ligjin për ndihmën juridike brenda 2 muajsh i cili do të dërgohet MYLA dhe Vasa Prava.

3. Përgatitja e një strukture të forumit në lidhje me organet drejtuese e cila do të miratohet në mbledhjen e ardhshme si dhe mundësia e krijimit të një bordi këshillues me ekspertë të huaj.



4. Një kopje e draftit raportit të takimit të tretë rajonal do ti dërgohet organizatave që nuk morrën pjesë.

5. Persa i perket kontakteve me donatoret, Vasa Prava do jete organizata qe do mbaje kontakte me donatoret e ndryshem.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS

MIGEN ELMAZAJ
Administratore, TLAS

DETYRIMI PËR USHQIM SI NJË NGA PASOJAT E ZGJIDHJES SË MARTESËS

Në legjislacionin shqiptar në marrëdhëniet e femijës me prindërit dhe familjen, ose që kanë të bëjnë me edukimin e fëmijës, prioritet i jepet të drejtave dhe detyrimeve që kanë prindërit, familja ose përfaqësuesit e tyre ligjor. E drejta e fëmijës për të pasur kujdesin





e prindërve është përcaktuar që në pjesën hyrëse të Kodit të Familjes nenet 2, 3, 4 e 5, sipas së cilëve, prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirëritjen, zhvillimin, mirëqënien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë. Çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi.

Problematikë e theksuar vitet e fundit është bërë shtimi i rasteve të zgjidhjes së martesave. Në rastet e zgjidhjes së martesës,

problemi është rregullimi i pasojave të saj dhe më tepër, ajo që ka të bëjë me zgjidhjen e pasojave që kanë lidhje me fëmijët. Me dhënien e vendimit për zgjidhjen e martesës, gjykata është e detyruar të përcaktojë edhe kujdestarinë e fëmijës dhe mënyrën e takimit me prindin jokujdestar. Por pas kësaj bëhet edhe përcaktimi i detyrimit ushqimor në favor të fëmijës. Gjykata përcakton edhe kushtet. Fëmija që është nën dhjetë vjeç i lihet në kujdestari të detyruar nënës, ashtu si e përcakton edhe ligji. Por ka edhe përjashtime. Kur nëna nuk është në gjendje ekonomike dhe shëndetësore të kujdeset për fëmijën dhe ky fakt përcaktohet nga psikologu, atëherë kujdestaria i kalon babait.

Gjithashtu, në Kodin e Familjes dhe në ligje të veçanta parashikohet detyrimi dhe e drejta e prindërve për tu kujdesur për ushqimin e fëmijës, arsimimin e tij.

Detyrim për ushqim kanë, sipas radhës: a) bashkëshorti ndaj bashkëshortit tjetër dhe

fëmijët ndaj prindërve të tyre; b) prindërit ndaj fëmijëve të tyre; c) të paslindurit ndaj të paralindurve të tyre, që nuk janë prindër, sipas radhës më të afërt; ç) të paralindurit ndaj të paslindurve të tyre, që nuk janë fëmijë të tyre, sipas radhës më të afërt; d) vëllezërit dhe motrat ndaj vëllezërve dhe motrave të tyre, sipas radhës më të afërt.

Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar. Një fëmijë i mitur mund t'u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij. Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç. Detyrimi për ushqim lind vetëm kur personi që kërkon këtë detyrim është i paaftë për punë dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të jetuar.

Detyrimi për ushqim mund të kërkohet vetëm nga ai që është

nevojtar dhe nuk është në gjen-dje të sigurojë nevojat e domosdoshme të tij. Detyrimi për ushqim duhet të caktohet në raport me nevojat e atij që e kërkon dhe mundësitë ekonomike të atij që detyrohet. Ai nuk duhet të kapërcejë atë që është e nevojshme për jetën e personit që përfiton detyrimin për ushqim, duke pasur parasysh rrethanat e jetës së tij.

Gjykata, me kërkesën e personit të interesuar, mund të pakësojë, të heqë ose të shtojë detyrimin për ushqim, të caktuar me vendim të formës së prerë, kur rrethanat në bazë të të cilave



është dhënë vendimi kanë ndryshuar më vonë. Detyrimi për ushqim mund të pakësohet edhe për shkak të sjelljes së çrregullt ose të qortueshme të personit që e përfiton atë. Nëse pas përcaktimit të detyrimit për ushqim konstatohet se një nga personat e detyruar në shkallë të mëparshme është në gjendje që ta japë atë, gjykata vendos zëvendësimin këtij detyrimi. Në këtë rast, personi i detyruar në shkallën e mëpasme nuk çlirohet nga ky detyrim, pa u caktuar detyrimi për ushqim ndaj personit në shkallën e mëparshme. Detyrimi për ushqim në rastet

kur ajo është një nga pasojat e zgjidhjes së martesës, fillon nga data e ngritjes së padisë. Pakësimi ose heqja e detyrimit për ushqim, të caktuar me vendim të formës së prerë dhe të paekzekutuar, fillon nga data kur kanë ndryshuar rrethanat, në bazë të të cilave është dhënë vendimi, kurse shtimi i tij fillon nga data e ngritjes së padisë. Kur një vendim, që përmban një detyrim për ushqim, vihet në ekzekutim pas 6 muajve nga data që ka marrë formë të prerë, detyrimet e prapambetura për ushqim janë të kërkueshme vetëm për 6 muajt e fundit.

E drejta për të kërkuar detyrimin për ushqim nuk mund t'i kalojë një personi tjetër.

Personi që ka detyrimin për ushqim nuk mund të kërkojë që ky detyrim të shlyhet me një kredi që ka ndaj personit që e përfiton atë, edhe sikur të ketë detyrime të prapambetura për ushqim.

Detyrimi për ushqim pushon me vdekjen e personit të detyruar, personit që e përfiton atë, edhe sikur ky detyrim, që përmbahet në një vendim të formës së pre-



rë, të mos jetë ekzekutuar.

Vendimi i Gjyktës i formës së prerë që përmban detyrimin për ushqim për fëmijët, përbën titull ekzekutiv dhe në mënyrë që të vihet në ekzekutim, kërkuesi i drejtohet Gjykatës për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit. Me lëshimin e këtij Urdhri nga ana e Gjykatës, në rastet kur detyrimi për ushqim nuk përmbushet në mënyrë vullnetare nga pala e detyruar, ai mund të vihet në ekzekutim nga Përmbarimi Gjyqësor në formën dhe mënyrën që përcakton ligji për ekzekutimin e detyrueshëm. Përmbaruesi Gjyqësor në zbatim të Kodit të Procedurës Civile nëpërmjet procedurës së ekzekutimit, kur nuk ka përmbushje vullnetare nga ana e personit të detyruar, vë dorë mbi të gjitha pasuritë e gjendshme të debitorit duke filluar që nga paga e tij, pasuritë e luajtshme e të paluajtshme deri në kufijtë e nxjerrjes dhe përmbushjes së detyrimit.

ADNAN HOXHA
Avokat, TLAS

Histori e Vërtetë 1

Pranë Zyrës tonë u paraqit një kliente rome me initiale S.S, e cila pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë u paraqit duke kërkuar që të përfaqësohej nga TLAS në procesin gjyqësor për zgjidhjen e martesës, e cila në fakt rezultoi të ishte pavlefshmëri martese.

Nga ana e zyrës u procedua në mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm për të kryer zgjidhjen e martesë në gjykatë. Gjatë mbledhjes së dokumen-





tacionit u vu re në përgjigjet që ktheu Zyra e Gjendjes Civile pranë së cilës ishte e regjistruar klientja, se klientja figuronte e martuar në regjistra, por Zyra e Gjendjes Civile nuk mund të lëshonte Çertifikatën e Martesës, që nevojitet në gjykim për vërtetimin që ekziston martesë midis personave. Arsyeja që nuk mund të lëshohej kjo çertifikatë ishte për faktin se në regjistrat e gjendjes civile nuk figuronte asnjë Akt Martese midis klientes dhe bashkëshortit të saj. Kjo passillte problemin që në një rast të tillë nuk mund të procedohej me një

padi për zgjidhje martesë, pasi një martesë e tillë e pashoqëruar me një Akt Martese, do të thotë një martesë jo e lidhur para nëpunësit të gjendjes civile, kusht për vlefshmërinë e saj siç e kërkon shprehimisht Kodi i Familjes në Nenet 8 e 28 të tij.

Në kushte të tilla, mënyra ligjore për t'u drejtuar Gjykatës për zgjidhjen e këtij problemi që doli i paparashikuar ishte vetëm me një padi për pavlefshmërinë e martesës. Kodi i Familjes në Nenin 42 të tij parashikon që "Martesa që nuk është lidhur publikisht përpara nëpunësit të gjendjes civile është e pavlefshme. Kërkesa mund të bëhet nga bashkëshortët, nga prindërit e tyre, nga të paralinjurit, nga të gjithë ata që kanë një interes të drejtpërdrejtë si dhe nga prokurori.

Procedura në këtë lloj gjykimi është pothuajse e ngjashme me atë të zgjidhjes së martesës. Padia ngrihet duke thirrur si të paditur bashkëshortin, dhe e veçanta është që thirret edhe si person i trete Zyra e Gjendjes Civile, për shkak se ajo disponon

aktet apo mund të japë shpjegime për aktet që nuk janë mbajtur në rastin konkret.

Klientja dhe bashkëshorti i saj kishin fëmijë të lindur gjatë bashkëjetesës së tyre. Lidhur me pasojat në rast të konstatimit të pavlefshmërisë së kësja martese Kodi i Familjes në Nenin 49 të tij parashikon që “Martesa që shpallet e pavlefshme me vendim të formës së prerë konsiderohet se nuk është lidhur. Për bashkëshortin që nuk ka ditur shkakun e pavlefshmërisë së martesës, pasojat fillojnë nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Fëmijët e lindur nga një martesë që shpallet e pavlefshme, quhen sit ë lindur nga martesa dhe marrëdhëniet midis tyre dhe prindërve rregullohen sin ë rastet kur zgjidhjet martesa. Neni 138/1 i Kodit të Familjes shprehet:”Në kërkesëpadinë për zgjidhjen e martesës mund të kërkohet edhe detyrimi i bashkëshortit tjetër për të përballuar shpenzimet për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, shpenzimet për jetesë të bashkëshortit nevojtär,



në rastet e parashikuara në këtë Kod”.

Në padinë e paraqitur në Gjykatë, përveç sa më sipër u kërkua që fëmijët ti liheshin për rritje dhe edukim nënës së tyre (klientes së zyrës) duke qenë se ata kishin jetuar gjatë gjithë kohës me të dhe detyrimin e babait që të paguante detyrimin ushqimor deri sa të mbushin moshën madhore.

Pas kryerjes së të gjitha procedurave, hartimit të Raportit Psikologjik edhe nga psikologia e çështjes, gjykata mori vendim për shpalljen e pavlefshmërisë

së kësaj martese, lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim nënës së tyre, të drejtën e babait për ti takuar, dhe detyrimin e tij për të paguar pension ushqimor për fëmijët deri kur ata të arrijn moshën madhore.

ADNAN HOXHA
Avokat, TLAS

Histori e Vërtetë 2

Klienti F.H është gjyshi i një fëmije të mitur për të cilin kërkonte të caktohej kujdestar ligjor. Fëmija ishte i lindur nga martesa e djalit të klientit të zyrës me bashkëshorten e tij. E ëma e kishte braktisur djalin që kur ai ishte ende foshnje. Për rritjen e tij ishin kujdesur i ati dhe gjyshërit. Kohët e fundit kishte ndërruar jetë edhe i ati i fëmijës dhe të vetmit që kujdeseshin për fëmijën ishin gjyshërit që në njëfarë mënyre faktikisht ushtrojnë kujdestarinë duke u kujdesur për mirërritjen e tij. Nëna e fëmijës edhe pas vdekjes së të atit të fëmijës nuk ishte shfaqur në jetën e tij për tu interesuar apo dhënë kontribut në mirërritjen e tij.

Pasi u paraqit në zyrën tonë dhe pasi u diskutua çështja nga këshilltari i projektit dhe nga të gjithë avokatët e zyrës u mendua që të mblidheshin dokumentat e nevojshëm dhe të paraqitej çështja në gjykatë.



Sipas nenit 224 të kodit të Familjes “Në qoftë se prindërit e fëmijës kanë vdekur, janë në pamundësi të ushtrojnë përgjegjësi prindërore për shkak të pazotësisë për të vepruar, të mungesës së tyre ose për arsye të tjera të rënda, fëmija mund ti besohet nje anëtarit të familjes”. Në këtë rast ndodheshim përpara të njëjtin rast kur njëri nga prindërit kishte vdekur dhe prindi tjetër nuk e ushtronte efektivisht përgjegjësinë prindërore.

Sipas nenit 263 të Kodit të Familjes “Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si të pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata.

Gjykatë kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit.”.

Sipas nenit 264 të Kodit të Familjes “të drejtën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë për kujdestar mbi të miturin e kanë: të afërmit e fëmijës së mitur ...”.

Neni 270 i Kodit të Familjes parashikon shkaqet e papajtueshmërisë së të qenit kujdestar i cili nuk mund të jetë i tillë kur: a) është vetë në kujdestari; b) ka konflikt interesash me të miturin; c) nuk ka administrimin e lirë të pasurisë së tij; ç) është përjashtuar nga kujdestaria për shkak të deklarimit me shkrim të prindit që ka ushtruar i fun-



dit përgjegjësinë prindërore; d) ka humbur ose i është hequr përgjegjësia prindërore, ose është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër; dh) është i dënuar me burgim për një vepër penale dhe është gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si dhe kur është dënuar për krime ndaj të miturve. e) ka mbushur moshën 65 vjeç; ë) për shkak të gjendjes së tij shëndetësore nuk mund ta ushtrojë me lehtësi kujdestarinë; f) ushtron përgjegjësinë prindërore në më shumë se tre fëmijë; g) është i ngarkuar me më shumë se dy kujdestari; gj) nuk jep pëlqimin për të qenë kujdestar.

U. procedua për mbledhjen e të gjithë dokumentave të nevojshëm që do të shërbenin në këtë rast duke u marrë të gjithë dokumentat e kërkuara për të vërtetuar në rradhë të parë përmbushjen e kërkesave të mësipërme të ligjit që duhen plotësuar për të qenë kujdestar dhe po ashtu edhe dokumentat që provonin faktin që fëmija ishte nën kujdesin faktik të gjyshërve të tij dhe se nëna nuk interesohej pothuajse aspak dhe nuk kontribuonte në rritjen dhe edukimin e tij.

Pasi u mbledhën këto dokumenta u përpilua kërkesa për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe u paraqit kërkesa në gjykatë.

Pas disa seancave gjyqësore gjykata arriti në përfundimin se e gjente të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesën e bërë nga klienti F.H. duke i dhënë të drejtë për kerkimin e tij.

ADNAN HOXHA
Avokat, TLAS



SHTETËSIA SHQIPTARE, FITIMI, HUMBJA DHE RIFITIMI I SAJ

Shtetësia shqiptare është një lidhje e qëndrueshme juridike, që shprehet në të drejtat dhe detyrat e ndërsjella të personit fizik dhe të shtetit shqiptar. Shtetësia shqiptare fitohet, rifitohet, humbet apo lihet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, i cili respekton normat e parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare në fushën e shtetësisë të pranuar nga Republika e Shqipërisë. Sipas këtij ligji është shtetas shqiptar:

- a) Çdo person, i cili ka pasur shtetësinë shqiptare deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji;
- b) Çdo person, që fiton shtetësinë shqiptare në bazë të këtij ligji.

Bazuar në ligjin shqiptar shtetasi shqiptar mund të jete edhe shtetas i një shteti tjetër, pra



legjislacioni shqiptar e njeh dyshtetësinë.

Askujt nuk mund t'i hiqet arbitrisht shtetësia shqiptare.

Çdo shtetas shqiptar ka të drejtë të heqë dorë nga shtetësia shqiptare me kusht që të ketë një shtetësi tjetër, të ketë fituar një shtetësi tjetër apo t'i jetë garantuar nga organet kompetente të shtetit të huaj dhënia e një shtetësie tjetër.

Shtetësia shqiptare fitohet me:

- a) lindje;
- b) natyralizim;
- c) birësim.



Fitimi i shtetësisë shqiptare me lindje nënkupton që:

Një fëmijë fiton shtetësinë shqiptare me lindje në rastet kur:

1. të dy prindërit, në kohën e lindjes së fëmijës, janë shtetas shqiptarë;
2. njëri prej prindërve, në kohën e lindjes së fëmijës, është shtetas shqiptar dhe fëmija lind në territorin e Republikës së Shqipërisë . Përfshihen rastet kur prindërit, bashkërisht, vendosin që fëmija të fitojë shtetësinë e prindit tjetër;
3. ka lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe njëri

prej prindërve është shtetas shqiptar, ndërsa prindi tjetër është me shtetësi të panjohur ose pa shtetësi;

4. ka lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe njëri prej prindërve është shtetas shqiptar, ndërsa prindi tjetër ka një shtetësi tjetër, por të dy prindërit bien dakord që fëmija të marrë shtetësinë shqiptare.

Gjithashtu ligji parashikon fitimin e shtetësisë shqiptare edhe për rastet kur:

1. Një fëmijë i lindur ose i gjetur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë merr shtetësinë shqiptare në rast se ai është lindur nga prindër të panjohur, dhe si pasojë fëmija do të mbetet pa shtetësi.

Në rast se prindërit e fëmijës bëhen të njohur përpara se fëmija të ketë arritur moshën 14 vjeç, dhe ata janë me shtetësi të huaj, shtetësia shqiptare mund të hiqet më kërkesë të prindërve të njohur ligjërisht, me kusht që fëmija të mos mbetet pa shtetësi si pasojë e këtij veprimi.

2. Një fëmijë i lindur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga prindër me shtetësi tjetër, të cilët janë rezidentë të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të marrë shtetësinë shqiptare me pëlqimin e të dy prindërve.

Fitimi shtetësisë shqiptare nuk kushtëzohet vetëm nga faktori i lindjes, por një person mund të bëhet shtetas shqiptar edhe me natyralizim duke plotësuar këto kushte të parashikuara nga ligji:

1. Të ketë mbushur moshën 18 vjeç.
2. Të ketë banuar ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të vazhdueshme, për jo më pak se 5 vjet.
3. Të kete banesë dhe të disponoje të ardhura të mjaftueshme.
4. Të mos ketë qenë ndonjëherë i dënuar në shtetin e vet apo në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 vjet heqje lirie.



Përrjashtim nga ky rregull bëhet vetëm në ato raste kur vërtetohet se dënimi është dhënë për motive politike.

5. Të ketë njohuri, të paktën fill-estare, të gjuhës shqipe;
6. Pranimit i tij si shtetas shqiptar të mos prekë sigurimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë ;
7. Të huajit, që ka mbushur moshën 18 vjeç, mund t'i jepet shtetësia shqiptare me natyralizim edhe në qoftë se nuk plotëson kushtet e këtij ligji, me përjashtim të pikës 6, në qoftë se Republika e Shqipërisë ka një

interes shkencor, ekonomik, kulturor dhe kombëtar.

Në rast se personi është pa shtetësi, kushtet e pikës 1, 3, 4 dhe 5 nuk merren parasysh.

Në rast se i huaji vërtetohet se është me origjinë shqiptare deri në dy shkallë, qoftë edhe nga njëri prind, koha e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, e përmendur në pikën 2, duhet të jetë të paktën 3 vjet.

I huaji që është i martuar me një shtetas shqiptar prej jo me pak se 3 vjetësh, në rast se dëshiron, mund të fitojë shtetësinë shqiptare me natyralizim, në këtë rast i huaji duhet të ketë banuar, në mënyrë të vazhdueshme dhe të

ligjshme, në territorin e Republikës së Shqipërisë të paktën një vit.

Në rast se të dy prindërit fitojnë shtetësinë shqiptare me natyralizim, fëmija i tyre, nën moshën 18vjeç, kur jeton me prindërit, bëhet gjithashtu shtetas shqiptar me kërkesën e prindërve dhe me pëlqimin e fëmijës, në qoftë se ky është në moshën 14-18 vjeç.

Në rast se njëri prej prindërve fiton shtetësinë shqiptare, fëmija i tij nën 18 vjeç bëhet shtetas shqiptar, në se kjo kërkohet nga të dy prindërit, ose nga njëri prej prindërve kur prindi tjetër është pa shtetësi dhe fëmija ka vendbanimin në Republikën e Shqipërisë.

Por ka edhe një mënyrë tjetër për fitimin e shtetësisë shqiptare sipas legjislacionit shqiptar, që është birësimi.

Në rast se dy prindërit me shtetësi shqiptare birësojnë një të mitur të një shtetësie tjetër apo pa shtetësi, fëmija fiton shtetësinë shqiptare.

I mituri i birësuar e fiton shtetësinë shqiptare edhe kur njëri prej



prindërve është shqiptar dhe të dy prindërit, në çastin e birësimit, banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në çdo rast tjetër kur fëmija rrezikon të mbetet pa shtetësi, si rezultat i birësimit.

Nga shtetësia shqiptare shtetasi gjithashtu mund të heqë dorë në rastet kur shtetasi:

1. Ka mbushur moshën 18 vjeç.
2. Nuk mbetet pa shtetësi si rezultat i heqjes dorë nga shtetësia shqiptare, meqenëse ka shtetësi të huaj, fiton shtetësi të huaj ose garanton se do të fitojë shtetësi të huaj.
3. Është rezident në një shtet të huaj.
4. Nuk është në ndjekje penale për vepra penale, për të cilat, sipas legjislacionit shqiptar, parashikohet dënim me burgim jo më pak se 5 vjet.
5. Nuk ka detyrime ligjore ndaj autoriteteve shtetërore, personave juridikë dhe fizikë.



Vendimi për njohjen e faktit të heqjes dore nga shtetësia shqiptare mund të revokohet, kur vërtetohet se ish-shtetasi shqiptar, me vetëdije, ka përdorur të dhëna të pasakta ose dokumente të falsifikuara për lënien e shtetësisë.

Por mund të ndodhë që shtetasi shqiptar i cili kërkon të heqë dorë nga shtetësia shqiptare, të përmbushë kushtet e përmendura më sipër, por për arsye të ndryshme ai nuk e fiton shtetësinë tjetër të premtuar dhe si pasojë ai mbetet pa shtetësi. Në këto rrethana shtetasi mund të aplikojë për rifitim të shtetësisë shqiptare.

Kërkesa për rifitim (si dhe për heqjen dorë por edhe për fitimin) nga shtetësia shqiptare paraqitet në organet e Ministrisë së Brendshme të vendbanimit të personit ose, në rast se personi banon jashtë shtetit, në përfaqësitë diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. e shoqëruar me dokumentet e kërkuara nga ky ligj.

Për sejcilin nga rastet, pra për fitimin, lënien apo rifitim e shtetësisë shqiptare, shtetasi duhet të paraqesë kërkesën e tij të shoqëruar nga dokumentat e kërkuara në institucionet e sipërmendura.

ANISA METALLA
Avokate/këshilltare paraligjore,
TLAS



Histori e Vërtetë 1

Rasti i klientes E.V.

Klientja E.V u drejtua në zyrat e TLAS, për të marrë ndihmë ligjore përse i përket të drejtës së saj për të përfituar pension pleqërie.

Klientja i ka drejtuar një kërkesë Institutit të Sigurimeve Shoqërore për të përfituar pension pleqërie, e cila i është refuzuar prej Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore me arsyetimin se klientja figuron në regjistrin themeltar të vjetërsisë në punë me emër ndryshe ndërsa mbiemri është i njëjti, Inicialet e saj janë E.V ndërkohë rezulton me inicialet M.S. Klientja në çertifikatën e lindjes së gjendjes civile të Komunës, rezulton me emrin E.V. dhe se duhet bërë njohja në rrugë ligjore se bëhet fjalë për të njëjtin person.

Klientja E.V. ka filluar punën në kooperativën bujqësore në vitin 1960, kur ajo ishte në një moshë

të mitur deri në mbylljen e kooperativës bujqësore në vitin 1992, siç rezulton nga vërtetimi “për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore” të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Që prej vitit 1993 deri në 2007, ajo është siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi, siç vërtetohet nga vërtetimi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore sipas të dhënave të regjistrit themeltar.

Dokumentivërtetim “për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore” të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i vitit 2008, përmban pasaktësi të emrit të klientes E.V. bazuar në regjistrin themeltar të vjetërsisë në punë, ndërkohë sipas çertifikatës së lindjes së gjendjes civile të Komunës emri i saj i saktë është E.V.

Në regjistrat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore del dhe një pasaktësi tjetër. Ky vërtetim gjithashtu nuk përmban të gjitha vitet e punës që klientja ka punuar që prej vitit 1960 deri në 1992 dhe shumë vite të punës nuk janë shënuar.

E vetmja rrugë për t'i dhënë problemit zgjidhje të drejtë dhe ligjore është vërtetimi i faktit se klientja me inicialet E.V. është i njëjti person që mban inicialet M.S. dhe se ajo realisht ka punuar në kooperativën bujqësore nga viti 1960 deri në vitin 1992.

Kjo zgjidhje jepet në Kodin e Procedurës Civile ku sipas nenit 388 të paragrafi i tretë, kërkohet që *“kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që e vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë. Kërkesa paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banim kërkuesi. Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet korigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni”*.

Pasaktësia e këtij vërtetimi do të provohet me prova shkresore – me vërtetimin për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore” të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, e vitit 2008, vërtetimin për të vetëpunësuarit në bujqësi e lëshuar prej Instituti i Sigurimeve Shoqërore e vitit 2007, çertifikatën e lindjes së gjendjes civile të Komunës, vërtetimin e Komunës, në të cilën kryetari i Komunës vërteton se klientja E.V. është banore e vjetër në këtë Komunë, vërtetimin e kryetarit të fshatit, ku ajo banon, ku deklarohet i njëjti

fakt, se klientja është banore e këtij fshati. Këtë pretendim ajo e bazon dhe e provon dhe me thëniet e majft dëshmitarëve, të cilët kanë punuar me të.

Nga këto prova rezulton plotësisht se vërtetimi për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore” të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dt 2008, përmban pasaktësi në emrin e klientes dhe të viteve të saj të punës në kooperativë.

Klientja nuk mund ta provojë pretendimin në rrugë tjetër veç asaj gjyqësore dhe nga vërtetimi i tij rrjedhin pasoja juridike që lidhen me efektet e realizimit të drejtave dhe detyrimeve të saj dhe interesave të ligjshme.

ANISA METALLA
Avokate/këshilltare paraligjore,
TLAS



Histori e Vërtetë 2

Rasti i klientes S.B.

Pranë zyrës së Shërbimit Ligjor Falas u paraqit një kliente me inicialet S.B. Kjo kliente u referua në zyrën tonë nga një organizatë tjetër.

Klientja është gjyshja e katër fëmijëve të mitur. Të katër këta fëmijë janë fëmijët e vajzës së saj. Vajza e klientes tre prej fëmijëve i ka lindur nga martesë, ndërkohë fëmijën e tretë e ka lindur nga një marrëdhënie jashtëmartesore.

Vajza e klientes e ka zgjidhur martesën ligjore, pasi ajo ka patur probleme me ish bashkëshortin e saj, i cili gjithashtu prej disa kohësh e kishte braktisur familjen. Gjithashtu vetë nëna e fëmijëve ka patur gjatë gjithë kohës probleme të shëndetit mendor gjë që e ka bërë të vështirë procesin e ushtrimit të përgjegjësisë së saj prindërore ndaj fëmijëve.

Gjatë kohës që ka qënë e lidhur në martesë, kjo shtetase gjithashtu ka sjellë në jetë edhe një fëmijë tjetër nga një lidhje jashtë martesore, lidhje e cila ka përfunduar. Fëmija është i regjistruar në gjëndjen familjare të nënës, babai ja ka njohur atësinë por nuk e ka pranuar asnjëherë këtë fëmijë duke mos u interesuar kurrë për të.

Për shkak të gjëndjes së paqëndrueshme mendore të vajzës së klientes sonë, për fëmijët është kujdesur vazhdimisht që prej lindjes vetë S.B., e cila është edhe gjyshja biologjike e fëmijëve.





Fëmijën e parë të vajzës së saj S.B. e ka sistemuar pranë Fshatit SOS, duke qënë se ka qënë në kushte mjaft të vështira ekonomike. Për këtë fëmijë institucioni "SoS Fshatrat e Fëmijëve" gëzon edhe statusin e kujdestarit ligjor me vendim të gjykatës.

Për tre fëmijët e tjerë klientja u drejtua në zyrën tonë për të filluar procedurat gjyqësore për marjen e kujdestarisë ligjore për fëmijët e mitur.

Fillimisht u konstatua nëse egzistonte kushtet ligjore për ngritjen e kërkesës për marjen e kujdestarisë.

Rezultonte nga faktet e treguara nga klientja, por edhe nga dokumentat e paraqitura prej saj, që ajo ishte kujdestarja e vetme "de facto" e fëmijëve të mitur. Për të tre fëmijët e parë të ardhur nga martesë e vajzës së saj, nga ana e babait të tyre prej një kohe shume të gjatë, nuk kishte patur asnjëherë komunikim dhe as kontribut emocional dhe material.

Nga ana e nënës së tyre vajzës së kërkuësës, fëmijët kishin patur që prej lindjes vetëm figurën e saj fizike, pasi për shkak të problemeve mendore ajo nuk kishte patur asnjëherë një stabilitet emocional dhe afektiv me fëmijët, duke ju shmangur kështu detyrimeve prindërore. Në këtë mënyrë i vetmi person që ishte kujdesur vazhdimisht për fëmijët në mënyrë të qëndrueshme ishte gjyshja e tyre, klientja S. B.

Duke ju referuar Kodit të Familjes nenit 263, thuhet se: *"Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi*

për te ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se te dy prindërit kane vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si te pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për te vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër te pranuar nga gjykata.

Gjykate kompetente për vendosjen ne kujdestari te te miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit te te miturit”

Gjithashtu në nenin nenit 269parashikohet: *“Për të miturit që janë vëllezër dhe motra caktohet një kujdestar I vetëm, përvec rastit kur rrethanat e vecanta kërkojnë domosdoshmërinë e caktimit të më shumë se një kujdestari”.*

Pra, egzistonte hapsira ligjore që klientja S.B. të legjitimoj për të kërkuar vendosjen e kujdestarisë ligjore mbi të tre të miturit. Fakti që të miturit janë vëllezër e motra e bënte të legjitimuar kërkuiesen që të kërkonte të ishte kujdestare e vetme.

Në këto kushte u fillua nga puna për mbledhjen e dokumentave të kërkuara të cilat do të përdoreshin si prova në gjykim. Më pas u procedua me dërgimin e rastit në gjykatë.

Gjithashtu si palë të treta në këtë gjykim u thirrën nëna e fëmijëve e cila ishte dakort për vendosjen e fëmijëve në kujdestarinë e gjyshes. Po ashtu u thirrën edhe baballarët e fëmijëve të cilët nuk u paraqitën asnjëherë në gjykim. Po ashtu në këtë gjykim u thirr sektori i ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë Bashkisë nëpërmjet punonjësës sociale, e cila përgatiti një raport vlerësi-



mi lidhur me kushtet sociale ekonomike të kërkueses, klientes S.B. Po ashtu një psikologe e caktuar nga gjykata, e thirrur në cilësinë e ekspertes në gjykim, hartoi një raport vlerësimi psikologjik të situatës së fëmijëve, nivelit të atashimit të tyre me klienten S.B.

Nga i gjithë shqyrtimi gjyqësor rezultoi që kushtet ishin në favor të pretendimeve të klientes S.B. Kështu u arsyetua nga gjykata që ishte në interesin më të lartë të fëmijëve që ata të vendoseshin të tre në kujdestarinë e gjyshes së tyre, klientes S.B.

ANISA METALLA
Avokate/këshilltare paraligjore,
TLAS



Ç'NJOHJA E ATËSISË (KUNDËRSHTIMI I ATËSISË)

Një nga konceptet më të rëndësishme që është parashikuar edhe në Kodin e Familjes është "Atësia". Vetë termi Atësi përfshin a) njohjen e atësisë dhe b) ç'njohjen e atësisë.

Janë pikërisht rastet e njohjes së atësisë për fëmijët të cilët janë fryt i bashkëjetesës të cilat hasen më shumë në praktikën gjyqësore shqiptare.

Në këto raste ligji parashikon si procedurë faktin e paraqitjes së personit që kërkon të njihet si atë i një fëmije të lindur jashtë martese me paraqitjen e tij pranë Zyrës së Gjëndjes Civile të nënës dhe me deklarin e tij për atësinë e fëmijës si më poshtë:

Atë i fëmijës së lindur jashtë martese është personi madhor që e njuh fëmijën si të tij. Njohja e atësisë është e vlefshme kur për këtë jep pëlqimin nëna e fëmijës, të cilën e

lajmëron nëpunësi i gjëndjes civile. Kur nëna e kundërshton këtë njohje ose nuk përgjigjet

brenda 1 muaji nga marrja e lajmërimit, burri që ka njohur fëmijën si të tij mund të ngrejë padi para gjykatës kompetente për të vërtetuar se ai është i ati i fëmijës.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti nga data e marrjes së lajmërimit nga nëpunësi i gjëndjes civile, për mospranimin nga ana e nënës.

Pra një pjesë mjaft e rëndësishme e procesit është pëlqimi i dhënë nga nëna e fëmijës.

Pra, në rastin konkret, nëna dhe babai pretendues i fëmijës duhet të paraqiten në zyrën e gjëndjes civile të pajisur me dokumente identifikimi, t'i dorëzojnë punonjësit të gjëndjes civile çertifikatën e asistencës në lindje dhe duhet të deklarojnë atësinë e fëmijës përpara punonjësit të gjëndjes civile. Punonjësi plotëson rubrikat e aktit të lindjes me të dhënat e plota të dy prindërve dhe mban procesverbalin përkatës të nënshkruar nga të dy personat e mësipërm .

Një aspekt tjetër mjaft i rëndësishëm për të drejtën familjare shqiptare por që haset më rrallë në praktikën gjyqësore janë rastet e kundërshtimit të atësisë për fëmijët që lindin si rezultat i një marrëdhënie të ligjëruar me martesë ligjore.

Kodi I familjes në nenin 180 të tij shprehet se : Fëmija që ka lindur gjatë martesës prezumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës.

Fëmija që ka lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës ose nga shpallja e pavlefshmërisë së martesës prezumohet se ka për atë ish-bashkëshortin e nënës.





Kur fëmija ka lindur gjatë vazhimit të martesës së dytë të nënës, prezumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës me martesë të dytë, edhe sikur fëmija të këtë lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës së parë ose nga shpallja e pavlefshmërisë së saj.

Në këtë rast ndodhemi përpara prezumimit ligjor përsa i përket atësisë dhe amësisë së fëmijëve, sidomos përsa i përket atësisë pasi është një process mjaft delikat.

Nga dispozita e sipërcituar është e qartë se në rastet kur fëmija

lind nga një nënë e cila plotëson kriteret e mësipërme (e martuar, me martesë të zgjidhur, me martesë të shpallur të pavlefshme) ndodhemi para rastit të përcaktimit të përbërësit të gjëndjes civile « atësia » mbi bazën e prezumimit, ndërsa kur fëmija lind nga një nënë e pamartuar ndodhemi para rastit të caktimit të përbërësit të gjëndjes civile sipas « veprimeve të vetë personit ».

Ndërkohë që në rastet që egzistojnë kushtet ku atësia e fëmijës nuk është bashkëshorti i nënës por një person tjetër ligji ka parashikuar se :

Burri, që sipas nenit 180 të këtij Kodi, prezumohet se është atë i një fëmijë, mund të kundërshtojë atësinë e këtij fëmijë.

Padia për kundërshtimin e atësisë ngrihet kundër fëmijës, i cili përfaqësohet nga nëna. Kur nëna është në pamundësi dhe fëmija është i mitur, i caktohet një kujdestar i posaçëm nga gjykata.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti, nga data që

burri ka marrë dijëni për lindjen e fëmijës.

Vlen të theksohet fakti se ligji e lidh të drejtën e ngritjes së padisë me një afat pas të cilit nuk mund ti drejtohesh gjykatës në bazë të parashikimeve të mësipërme.

Theksojme se raste të tilla janë të rralla dhe procese mjaft delikate.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS

Histori e Vërtetë 1

Pranë Zyrës tonë u paraqit një klient i qytetit të Tiranës me initiale S.K. Pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme të krijuara nga programi i Shërbimit Ligjor Falas nëpërmjet personave të tjerë që kishin marrë më parë shërbime ligjore nga zyra jonë, ajo u paraqit duke kërkuar kthimin e një shume të hollash të dhënë hua të cilën nuk ia kishin kthyer mbrapsht sipas kontratës së firmosur.



Nga intervista u konstatua se klienti S.K i kishte dhënë në formë huaje me interes (kamatë) një personi të tretë, shumën prej 400.000 lekë. Në këtë kontratë, të lidhur me shkresë të thjeshtë, është përcaktuar shuma e dhënë hua prej 400.000 (katërqindmijë) lekë të reja (në kontratë është pasqyruar 4 milion lekë të vjetra), është përcaktuar data e dhënies së huasë, afati i kthimit të saj 6 (gjashtë) muaj si dhe kamata (e shprehur me termin “interes”) prej 10% të shumës së mësipërme për çdo muaj.



Për të provuar këtë veprim juridik, personi i tretë i cili kishte marrë shumën hua kishte lëshuar edhe një deklaratë të shkruar dhe nënshkruar prej tij.

Që nga ajo kohë, klienti S.K kishte bërë përpjekje të vazhdueshme që huamarrësi të plotësonte detyrimin por, vazhdimisht ishte ndodhur para “premtimeve” se shumë shpejt ky detyrim do të përmbushej. Kishin mbetur vetëm premtime dhe, deri në castin që u paraqit në zyrën tonë nuk i ishte shlyer as edhe një lek nga ky detyrim.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin që të përpilohej dhe të ndiqej procedura gjyqësore për zgjidhjen e këtij konflikti.

U vendos të procedonim me hartimin e kërkesë padisë me objekt kthimin e shumës së dhënë hua, të kamatës së caktuar në kontratën e huasë si dhe shpërblimin e dëmeve nga mospërbushja në kohë e detyrimit për kthimin e huasë.

Neni 1050 i Kodit Civil shprehet se: “Me kontratën e huasë njëra

palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t'i kthejë huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit.

Neni 1051 i Kodit Civil shprehet se: Përveç kur me marrëveshje të palëve është parashkuar ndryshe, huamarrësi duhet t'i paguajë huadhënësit kamatat. Kamatat, për të cilat është rënë dakord, paguhen çdo vit, përveç kur palët kanë parashkuar ndryshe. Mospagimi i kamatave përbën mospërmbyllje thelbësore të detyrimit.

Klientja S.K kishte të drejtë në kerkimin e tij pasi ishte në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore.

U mbledhën të gjithë dokumentat e më pas u procedua me ndjekjen e gjyqit për Kthimin e shumës së dhënë hua, të kamatës së caktuar në kontratën

e huasë dhe që u finalizua me vendimin e gjykatës për ti dhënë të drejtë klientit S.K në kërkimin e tij për të marrë mbrapsht Shumën e dhënë hua si dhe kamatat ligjore që rridhnin prej saj.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS



Histori e Vërtetë 2

Pranë zyrës tonë u paraqit një kliente e qytetit të Tiranës me iniciale B.D. Pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme të krijuara nga programi i “Shërbimit Ligjor Falas Tiranë” nëpërmjet personave të tjerë që kishin marrë më parë shërbime ligjore nga zyra jonë, ajo u paraqit duke kërkuar pushimin e cënimit të pronësisë së saj nga personat e familjes të cilët i ndërhyenin pa të drejtë në të drejtën e saj për të gëzuar e qetë pronësinë që e kishte fituar me ligj.

Nga intervista u konstatua se klientja B.D kishte në pronësi të

saj një apartament të regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në emër të saj dhe kërkonte që të jetonte në këtë apartament e vetme me fëmijët e saj por nuk mund të jetonte dot pasi në shtëpi i kishin hyre disa familjar të saj të cilët refuzonin të dilnin prej saj me gjithë paralajmërimet e klientes B.D, madje duke e kërcënuar atë edhe me jetën e saj nëse ajo do të shkonte në polici ose do të ndërmernte ndonjë veprim ligjor për ti nxjerr ata jashtë apartamentit pavarësisht se ata nuk kishin asnjë dokument ligjor për të qëndruar në atë apartament.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin që të përpilohej dhe të ndiqej procedura gjyqësore për zgjidhjen e këtij konflikti.

U vendos të procedonim me hartimin e kërkesë padisë me objekt pushimin e cënimit të pronësisë së klientes B.D përsa i përket apartamentit të saj.

Neni 296 i Kodit Civil shprehet se: “Pronari ka të drejtë të ngrejë



padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës. Këtë të drejtë e ka edhe çdo bashkëpronar për sendin e përbashkët me qëllim që ai t'u dorëzohet të gjithë bashkpronarëve.

Klientja B.D kishte të drejtë në kërkimin e saj pasi ishte në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore madje ajo në atë kohë nuk mund të gëzonte pasurinë e vet, madje as nuk mund ta përdorte për qëllimin për të cilin ajo ishte krijuar që të jetonte në atë apartament me fëmijët e saj dhe të ishte ajo përdoruesja e vetme e tij.

U mbledhën një sërë dokumentash pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që vërtetonin pretendimet e saj si dhe dokumenta të tjera nga zyrat e administratës publike që të vërtetonin pretendimet e saj.

Më pas u procedua me ndjekjen e gjyqit për pushimin e cënimit të pronësisë së klientes B.D dhe që u finalizua me vendimin e gjykatës për ti dhënë të drejtë klientes B.D në kërkimin e saj për

të gëzuar e qetë pasurinë e saj të cilën e kishte fituar sipas të gjitha rregullave ligjore. Kështu aktualisht klientja B.D zotëron e qetë pasurinë e saj duke jetuar në atë apartament me fëmijët e saj. Vlen të theksohet se problemet që kemi hasur gjatë punës me popullsinë Rome janë mjaft të ndërlikuara, por pavarësisht këtyre pengesave zyra "Shërbimin Ligjor Falas" ka bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme që ti vijë në ndihmë jo vetëm komunitetit Rom të Tiranës, por edhe atij komuniteti që banon në qytete të tjera të Shqipërisë.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS



REGJISTRIMI I FËMIJËVE TË LINDUR JASHTË SHTETIT

Ka patur një vëmendje të veçantë nga ana e TLAS, për të gjetur një rrugë institucionale, për regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë shtetit. Megjithë punën shumë të mirë të bërë në këtë drejtim, që prej shumë vitesh dhe realizimin e regjistrimit të shumë fëmijëve të lindur jashtë shtetit, ende nuk është përcaktuar një rrugë institucionale, që të garantojë zgjidhjen

e çdo problemi, kudo që të ketë lindur fëmija.

Mbas ndryshimeve të shumta të kuadrit ligjor për regjistrimin e lindjes së fëmijëve, është zvogëluar ndjeshëm numri i fëmijëve të paregjistruar ende në zyrat e gjendjes civile. Ndër grupet e fëmijeve që nuk janë të regjistruar në zyrat e gjendjes civile, është edhe ai i fëmijëve të lindur jashtë shtetit, kryesisht në Greqi. Pengesat për regjistrimin e tyre janë për shkak se dokumentacioni i lindjes që prindërit kanë në Shqipëri, nuk është sipas ligjit.

Problemet për regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë shtetit kanë të bëjnë me:

1. Prindërit kanë çertifikatën e lindjes së fëmijës, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile të shtetit të huaj, me të gjitha të dhënat të plotësuar, por ky dokument nuk është i legalizuar nga autoritetet e shtetit të huaj dhe nga shërbimi konsullor shqiptarë në atë shtet, prandaj nuk



është gati për t'u përdorur nga zyrat e gjëndjes civile.

2. Prindërit kanë çertifikatën e lindjes së fëmijës, të lëshuar nga zyra e gjëndjes civile të shtetit të huaj, por në çertifikatë nuk figuron emri i fëmijës. Këto raste kanë të bëjnë me fëmijët e lindur në Greqi.

3. Prindërit kanë çertifikatën e asistencës në lindje, të lëshuar nga materniteti i shtetit të huaj, por kjo çertifikatë nuk është e legalizuar, pra nuk është gati për t'u përdorur nga zyrat e gjëndjes civile.

4. Prindërit nuk kanë asnjë dokument për fëmijën e lindur jashtë shtetit.

5. Prindërit kanë dokumenta të lindjes së fëmijës, por në dokument, janë raportuar të dhëna të pavërteta, për identitetin e nënës.

Si duhet të veprojnë prindërit e fëmijëve në rastet e sipërpërmendura?



Në rastin e parë: Çertifikata duhet të vërtetohet nga autoritetet e huaja dhe më tej duhet të legalizohet në konsullatën shqiptare.

Në rastin e dytë: Kjo çertifikatë nuk vlen në këtë formë, për të regjistruar fëmijën. Nëse prindi ka mundësi të rikthehet në vendin e lindjes së fëmijës, duhet të paraqitet me dokument identiteti në zyrën e gjëndjes civile ku është regjistruar fëmija, të deklarojë emrin e fëmijës dhe të marrë një çertifikatë lindje me emër fëmijë.



Në rastin e pestë: Prindi duhet t'i drejtohet gjykatës, për të bërë njohjen e faktit të lindjes së fëmijës.

Siç shihet nga rastet e përshkruara më sipër, prindi duhet të shkojë përsëri në vendin e lindjes së fëmijëve dhe duhet të plotësojnë këtë dokumentacion sipas kërkesave të ligjit. Por, në të gjitha këto raste, për shkak të pamundësisë ekonomike apo të padijes së prindërve për të ndjekur dhe paguar procedurat në shtetet e huaja, fëmijët kanë mbetur të paregjistruar në gjendjen civile.

Në rastin e tretë: Çertifikata e maternitetit duhet të vërtetohet nga autoritetet e huaja dhe më pas të legalizohet në konsullatën shqiptare.

Në rastin e katërt: Nëna duhet të drejtohet në zyrën e gjëndjes civile, apo në maternitet, e pajisur me document identifikimi dhe duhet të bëjë kërkesë për tërheqjen e çertifikatës përkatëse. Më tej duhet të bëhet vërtetimi dhe legalizimi i çertifikatës, në mënyrën e përshkruar më sipër.

Nga ana e TLAS është kërkuar ndihmë nga Ministria e Punëve të Jashtme, për përfshirjen e shërbimit konsullor shqiptare, në grumbullimin dhe legalizimin e dokumentacionit të lindjes së fëmijëve, të lindur jashtë shtetit. Do ishte ndihmë shumë e madhe për këto shtresa në nevojë, siguri i një bashkëpunimi të tillë, me Ministrinë e Punëve të Jashtme, për të autorizuar konsullatat shqiptare të realizojnë

grumbullimin dhe legalizimin e dokumentacionit. Kjo gjë do të reduktonte ndjeshëm numrin e fëmijëve të paregjistruar, që nuk përfitojnë asnjë të drejtë kushtetuese si shtetas shqiptarë dhe që janë pre e lehtë e trafikimit.

ELVIRA DERVISHI
Këshilltare Programi, TLAS

Histori e Vërtetë 1

L.C. është nënë kryefamiljare, me tre fëmijë dhe jeton në një barakë. E vetmja e ardhur e saj, është ndihma ekonomike, që ajo merr nga shteti. Kjo ndihmë është aq e vogël, sa që nuk del as për të ngrënë. Një problem shumë i madh për L.C. është mungesa e një banese të rregullt, ku ajo dhe fëmijët e saj, të mund të bëjnë një jetë më normale, duke u mbrojtur nga kushtet atmosferike të motit dhe ku fëmijët të mund të lahen e



të pastrohen normalisht, për t'u paraqitur në shkollë, si të gjithë bashkëmoshatarët e tyre.

Duke përfituar nga një projekt i Bashkisë së Tiranës, për përfitim të një Banese Sociale, me një qira shumë të reduktuar, TLAS ndihmoi dhe mbështeti financiarisht L.C., për të grumbulluar dhe plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Dokumentat që kërkohet të plotësohen dhe të dorëzohen në këtë rast janë:

1. Formulari tip i shpërndarë nga Bashkia e Tiranës, që shër-

ben për të regjistruar familjen e pstrehe në database-in e Bashkisë. Ky është dokumenti i parë që duhet plotësuar. Mbasi TLAS plotësoi të gjitha rubrikat e dokumentit, u bë noterizimi i tij tek noteri. Për këtë, nëna u paraqit tek noteri me dokumentin e plotësuar dhe me letërnjoftimin e ri elektronik. Mbas noterizimit, formulari u dorëzua në zyrën e strehimit, pranë Njesisë Bashkiake përkatëse. Të dhënat e këtij formulari hidhen në një database të posaçëm nga ana e punonjësve të Njesisë Bashkiake dhe kjo sjell futjen automatike të L.C. në listën zyrtare të të pastrehëve.

2. Çertifikata familjare e L.C. dhe çertifikata e saj familjare e vitit 1992.

3. Vërtetimi i banimit nga Njësia Bashkiake, ku u bë shënimi që L.C. trajtohet me ndihmë ekonomike dhe ku është shënuar edhe masa e ndihmës ekonomike.

4. Vërtetimi nga Zyra e Hipotekës, që L.C. nuk posedon asnjë pronë të regjistruar në emër të saj.



5. Vërtetimi nga Zyra e Tatimeve dhe Taksave, që L.C. nuk paguan ansjë tatim, apo taksë, pra nuk zotëron asnjë aktivitet privat.

6. Fotokopja e letërnjoftimit të L.C., e noterizuar.

7. Fotokopja e dokumentit të papunësisë, e lëshuar nga Zyra e Punës, e noterizuar.

8. Deklaratë noteriale tip për Banesë Sociale, që u realizua nga noteri.

Këto dokumenta u dorëzuan në Bashkinë e Tiranës, në pritje të shqyrtimit të tyre nga Këshilli Bashkiak. Para kalimit në këtë këshill, Drejtoria e Strehimit të Bashkisë së Tiranës bën caktimin e pikëve, sipas kushteve të secilës familje. Duke u nisur nga fakti që L.C. është nënë kryefamiljare, me tre fëmijë, mendojmë se do të ketë pikë maksimale dhe mund të përfitojë nga ky projekt.

ELVIRA DERVISHI
Këshilltare Programi, TLAS

Histori e Vërtetë 2

V.H. kishte qënë e martuar me B.A. dhe nga bashkëjetesa e tyre e shkurtër nuk patën fëmijë. Për shkak të mosmarrëveshjeve të gjata, V.H. u largua nga shtëpia e B.A. dhe pas disa vitesh filloi të bashkëjetonte me N.H. Ndërkohë, ajo vazhonte të ishte ligjërisht e martuar me B.A.

Gjatë bashkëjetesës së V.H. me N.H. lindën dy djem. Kur u shtrua në maternitet për të lindur fëmijët e saj, V. dha si mbiemër atë të personit me të cilin ajo bashkë-



jetonte prej vitesh dhe që ishte edhe babai biologjik i fëmijëve të saj. Në kushtet në të cilat ajo ndodhej, zyra e gjëndjes civile e komunës Gj. nuk mund të bënte regjistrimin e fëmijëve, si fëmijë të V. dhe N. Për këtë arsye, fëmijët vazhdonin të mos ishin të regjistruar në gjëndjen civile, megjithëse djali i madh arriti në moshën gjashtë vjeçare, ndërsa i vogli në moshën tre vjeçare.

Mbas një periudhe të gjatë bashkëpunimi me V., zyrën e gjëndjes civile të komunës dhe arkivin e zyrës së gjëndjes civile të prefekturës, TLAS arriti të realizojë një sërë procedurash administrative dhe gjyqësore.

Së pari u realizua zgjidhja e martesës së V. me shtetasin B.A. Më tej u bë lidhja e martesës së saj me N.H., që është edhe babai i fëmijëve. Gjatë procesit të mbajtjes së aktit të martesës, në përputhje me ligjin për gjëndjen civile, bashkëshortët deklaruan se kishin edhe dy fëmijë të lindur prej tyre, të paregjistruar në gjëndjen civile.

Më tej u mbajtën aktet e lindjes së dy fëmijëve, që u firmosën nga të dy prindërit. Përfundimisht, fëmijët u regjistruan në gjëndjen civile, duke shënuar si atësi, atë të babait të tyre biologjik, që në kohën e mbajtjes së akteve, figuronte edhe si bashkëshorti i nënës së tyre.

Realizimi i këtyre procedurave zgjati për një kohë relativisht të gjatë. Duke qënë se fëmijët nuk do të mund të regjistroheshin në gjëndjen civile para fillimit të procesit mësimor, TLAS pati një korespondencë me drejtorinë e shkollës, për të mundësuar regjistrimin e djalit të madh në shkollë, në mungesë të certifikatës së tij të lindjes. Ndërsa fëmija tjetër mundi të shkonte në kopësht. Tashmë të dy fëmijët janë të regjistruar në gjëndjen civile dhe ndjekin rregullisht edhe procesin e edukimit të tyre, përkatësisht në shkollë dhe në kopësht.

ELVIRA DERVISHI
Këshilltare Programi, TLAS

Seminar Trainimi

NDIHMJA LIGJORE DHE PAANËSIA E GJYKATËS

(seminar trainimi për studentët interns pranë administratës gjyqësore)

Bashkëpunoi



Mbështeti



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS, në bashkëpunim me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, GjT, dhe me mbështetjen financiare të Civil Rights Defenders, CRD, organizon në datat 25 dhe 26 Maj, 2011 në mjediset e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, seminarin dy ditor të trajnimit me temë: “Ndihmja Ligjore dhe Paanësia e Gjykatës” me pjesëmarrjen e studenteve interns të angazhuar me praktikën mësimore pranë Gjykatës së Tiranës.

Vendi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë

Datat: 25 dhe 26 Maj 2011

Mbështetës financiar : Civil Rights Defenders, (CRD)

Zbatues : Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)

Moduli I: “Përmirësimi i Shërbimeve të Gjyqësorit ndikon në rritjen e Aksesit në Drejtësi”

Moduli II: “Rëndësia e Administratës Gjyqësore për mirëfunksionimin e Pushtetit Gjyqësor”

Moduli III: “Përgjegjësitë e punonjësve të Gjykatës, dhe “Strategjitë e dhënies së ndihmës ligjore”

Moduli IV: “Drejtimet e ndihmës ligjore, pse punonjësit e gjykatës nuk mund të ofrojnë ndihmë ligjore të pakufizuar

Pyetje, diskutime dhe raste studimore për çdo modul



Seminar Trajnimi me studentet e Programit Internship në Gjykatën e Rrethit Tiranë





SHERBIMI LIGJOR FALAS TIRANE

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)
Rruga "Sami Frashëri"
4 kullat, Seksioni 3, Ap. 1A, Tirana, Albania
Tel/Fax: +355 4 2258 442
Tel: +355 4 2253 114
Kutia Postare 69
E-mail: tlas@tlas.org.al
www.tlas.org.al

TIRANA LEGAL AID SOCIETY

Design: ederstudio.com
Cel: 069 20 92 922

SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Nr. 3 / 2011

TLAS

